



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Agroekonomi

Programi: Ekonomia e Bujqësisë dhe ushqimit

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja **Bsc. Erëmira Ahmeti, me titull: “Vlerësimi i faktorëve socio-ekonomik në konsumin e djathit të bardhë “Euroлона” në regjionin e Prishtinës”**

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 10.03.2025 deri me datë _17.09.2025.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Asoc. Dr. Mustafë Pllana, kryetar,
2. Prof. Dr. Arben Musliu , mentor - anëtar,
3. Prof. Asoc. Dr Xhavit Ramadani , anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Dr. Arben Musliu përmes e-mail adresës: arben.musliu@uni-pr.edu .

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

Universiteti i Prishtinës
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
Departamenti i Ekonomisë së Bujqësisë dhe Ushqimit



PUNIM DIPLOME

Vlerësimi i faktorëve socio-ekonomik në konsumin e djathit të bardhë “Euroлона” në regjionin e Prishtinës”

Mentor:

Prof. Dr. Arben Musliu

Kandidate:

Bsc. Erëmira Ahmeti

Prishtinë 2025

Abstrakt

Bujqësia mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomikë të Kosovës, me një potencial të madh për zhvillim, pavarësisht sfidave ekzistuese. Ky studim përqendrohet në sektorin e qumështit, konkretisht djathin e bardhë, i cili ka pësuar goditje të rëndësishme pas luftës, por mbetet jetik për ekonominë bujqësore. Ndërhyrjet e qeverisë, përfshirë subvencionet për cilësinë e qumështit dhe nxitjet për rritjen e fermave, kanë qenë të dobishme, megjithatë, sektori përballet ende me vështirësi si konkurrenca e ulët dhe prodhimi i pamjaftueshëm.

Ky hulumtim ka pasur për qëllim të vlerësojë se a kanë ndikim faktorët socio ekonomik në konsumin e djathit të bardhë, dhe nëse po cilët janë këta faktorë. Hulumtimi është realizuar nëpërmjet pyetësorëve të mbledhur nga intervistimi i 300 respondentëve në regjionin e Prishtinës, ku më pas të dhënat nga pyetësorët janë përpunuar dhe analizuar në Excel dhe program statistikor SPSS (Statistical Package for the Social Science).

Rezultatet e arritura përmes përpunimit të dhënave në Excel dhe SPSS janë analizuar dhe në mënyrë të detajuar ka vijuar edhe komentimi i rezultateve në formë raporti të shkruar.

Me anë të gjetjeve të realizuara me anë të këtij studimi, vijmë në përfundim se faktorët socio-ekonomikë kanë ndikim të rëndësishëm në konsumin e djathit të bardhë. Faktorë të tillë si komuna, origjina e djathit, faktorët përcaktues të cilësisë së djathit, dhe shpenzimet mesatare mujore për djathë janë ndër faktorët socio-ekonomikë me ndikim më të madh në zgjedhjet e konsumatorëve.

Në këtë studim, është evidentuar se **91.7%** e personave kanë zgjedhur djathin me origjinë vendore, ndërsa **8.3%** e konsumatorëve kanë preferuar djathin e importuar. Kjo tregon një preferencë të theksuar për prodhimet vendore, çka mund të lidhet me faktorë si çmimi, disponueshmëria dhe besimi tek cilësia e produkteve vendore.

Gjithashtu, një pjesë e madhe e konsumatorëve kanë treguar se pajtohen pjesërisht me çmimet aktuale të djathit në treg. Sidoqoftë, **59.87%** e të anketuarve janë të kënaqur me plotësimin e kërkesave në treg, duke sugjeruar një balancë mes kërkesës dhe ofertës për këtë produkt.

Fjalët kyçe: Bujqësia, sektori i qumështit, faktorët socio-ekonomik, SPSS

Abstract

Agriculture remains one of the most important economic sectors in Kosovo, with great potential for development, despite the existing challenges. This study focuses on the dairy sector, specifically white cheese, which suffered significant setbacks after the war but remains vital for the agricultural economy. Government interventions, including subsidies for milk quality and incentives for farm expansion, have been helpful; however, the sector still faces difficulties such as low competition and insufficient production.

The aim of this research was to assess whether socio-economic factors have an impact on the consumption of white cheese, and if so, which factors are these. The research was conducted through questionnaires collected by interviewing 300 respondents in the Pristina region, and the data from the questionnaires were processed and analyzed in Excel and the statistical program SPSS (Statistical Package for the Social Sciences).

The results obtained through the data processing in Excel and SPSS were analyzed, and in detail, the results were further commented on in the form of a written report.

Through the findings obtained in this study, we conclude that socio-economic factors have a significant impact on the consumption of white cheese. Factors such as the municipality, the origin of the cheese, quality-determining factors of the cheese, and the average monthly expenditures for cheese are among the socio-economic factors with the greatest impact on consumers' choices.

This study revealed that 91.7% of people chose locally produced cheese, while 8.3% of consumers preferred imported cheese. This shows a strong preference for local products, which may be linked to factors such as price, availability, and trust in the quality of local products.

Additionally, a large part of the consumers indicated that they partially agree with the current prices of cheese on the market. However, 59.87% of respondents are satisfied with the fulfillment of market demands, suggesting a balance between supply and demand for this product.

Keywords: Agriculture, dairy sector, socio-economic factors, SPSS.

Evaluation of socio-economic factors in the consumption of "Eurolona" white cheese in the region of Pristina.

Key words: Agriculture , dariy sector , Socio-ekonomik factors, SPSS